



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1118/114 prot.

Tiranë, më 30.7.2024

V E N D I M
Nr. 31, datë 30.7.2024

P Ë R
PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR NDIHMËS LIGJORË QË NDOQËN
PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PËR VITIN AKADEMIK 2023 – 2024

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë për ndihmës ligjorë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në Programin e Formimit Fillestar nëntëmujor, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimeve 323, 324, 325, 326 datë 3.7.2024 dhe 359 datë 11.7.2024 të KLGJ-së, si dhe të rregullores së brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 30.7.2024,

V E N D O S I:

1. Të publikohet lista e kandidatëve për ndihmës ligjorë që kanë ndjekur programin nëntëmujor të Programit të Formimit Fillestar 2023-2024 dhe kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!